



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E SHËRBIMIT DHE KUJDESIT SOCIAL

Nr 13739/8 prot

Lezhë, me 20 / 08 / 2025

**PROÇESVERBAL PËR KONSULTIM PUBLIK PËR PLANIN VENDOR SOCIAL
2026-2028**

I mbajtur sot me date 20.08.2025, konsultim publik për miratimin e planit vendor social “Bashkia Lezhë”.

Pjesëmarrës 45 banorë të qytetit të Lezhës, të pranishëm Kryetari i Këshillit Bashkiak Lezhë si dhe përfaqësuesit nga institucionet dhe nga grupet e interesit në komunitet.

Fjala e mirëseardhjes u mbajt nga Drejtoresha e Shërbimit dhe Kujdesit Social znj. Marte Fetaj duke uruar mirëseardhjen për të ftuarit e më pas i kaloi fjalimin z.Ndue Luli, Kryetari i Këshillit Bashkiak Lezhë i cili theksoi rëndësinë e këtyre konsultimeve në qëllim të përmirësimit të planit social vendor znj. Marte Fetaj prezantoi planin social 2026-2028 ku plani paraprakisht është hartuar në bashkëpunim me të gjithë aktorët e shërbimit social me fokus grupe të ndryshme për të patur gjithëpërfshirje, znj. Fetaj listoi të gjitha objektivat dhe qëllimet e planit social, ku rol të veçantë i dha “Shërbimit të Kujdesit alternativ” Familjet kujdestare.

Prioritetet e këtij plani synojnë:

1. Ngritja dhe funksionimi i Qendres Multifunkionale në njesinë Administrative Shënkoll.
2. Ngritja dhe funksionimi i Shërbimit të kujdesit për fëmijë pa kujdes prindëror.
3. Ngritja e një qendre ditore dhe shërbim të integruar për të moshuarit.
4. Shërbimi i këshillimit me telefon online.

Gjatë takimit fjalën e mori znj. Alfrida Marku anëtare e Këshillit Bashkiak e cila vlerësoi nismën dhe theksoi që shërbimi social është pasaportë e mirëqeverisjes në pushtetin vendor, mbështet planin duke ofruar disa rekomandime sipas opinionit të saj. Do të jetë një zë në Këshillin Bashkiak gjithmonë në mbështetje të iniciativave sociale.

Gjithashtu fjalën e mori edhe z.Zef Lleshi përfaqësues i “Shoqates Së Të Verbërve” I cili mbështet planin dhe duke iu referuar ligjit 121/2016, shpreson që pushteti vendor me atë qendror të caktojë fonde me qëllim që personat me aftësi të kufizuar të jenë të pamvarur dhe infrastruktura të jetë më bashkëkohore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Rekomandimet e dala nga ky takim ishin:

- Përmirësimi i aksesit dhe godina e re e përshatshme për Qendren e Zhvillimit Ditor.
- Rikonstruksioni i rampeve në qytet .
- Infrastrukturë dhe burime të mjaftueshme për stafet e Shërbimeve Sociale që japin shërbim.

Diskutimi u mbyll me dakortësinë e të gjithëve, duke falenderuar për mbështetjen “ Shoqaten Kombëtare të bashkive të shqipërisë të cilët lehtësuan në planifikimin e këtij dokumenti strategjik, kalohet në një fazë tjetër, atë të miratimit të këtij plani, në strukturën e Këshillit Bashkiak.

Takimi zgjati 1 orë e 30 minuta me pjesëmarrje të aktorëve të ndryshëm në komunitet, konkretisht 45 të pranishëm nga ku 7 meshkuj dhe 38 femra.

Mbajti procesverbalin :Anita Kadeli

Drejtori i Shërbimit dhe Kujdesit Social: Marte Fetaj

Sekretare e Këshillit Bashkiak: Florida Çunaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

